



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 53 Akti

Nr. 22 Vendimi

Tiranë, më 07.06.2018

V E N D I M

Trupa gjyquese e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, e përbërë nga:

Suela Zhegu	Kryesuese
Pamela Qirko	Anëtare
Genta Tafa (Bungo)	Relatore

asistuar nga sekretare gjyqësore Znj.Olsida Goxhaj, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, Ferdinando Buatier De Mongeot, më datë 05.06.2018, ora 10:00, në Pallatin e Kongreseve, kati i dytë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Edmond Islamaj**, gjyqtar në Gjykatën e Lartë, i cili kërkoi konfirmimin në detyrë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE : **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar” (referuar më poshtë “Kushtetuta”).
Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (referuar më poshtë “Ligji nr. 84/2016”);
Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPA GJYKUESE E KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoji gjetjet dhe rekomandimin e relatores së çështjes, Znj. Genta Tafa (Bungo), mori në shqyrtim dhe analizoi shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen, duke u bazuar në të tri kriteret, vlerësimin pasuror, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, mbështetur në pikat 1 dhe 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

Subjekti i rivlerësimit, Z. Edmond Islamaj, ushtron detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Lartë dhe, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*.

Subjekti i rivlerësimit, në bazë të pikës 4 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, u është nënshtruar procedurave të rivlerësimit me përparësi, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur më datë 30.11.2017, në përputhje me “Rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit” nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (referuar më poshtë “Komisioni”).

Në referim të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit ndaj subjektit të rivlerësimit ka filluar menjëherë, pasi janë caktuar me short trupat gjyquese të Komisionit, si dhe është shortuar shpërndarja e çështjes konkrete, më datë 30.11.2017.

Në mbledhjen e trupës gjyquese të datës 14.12.2017, u caktua me mirëkuptim kryesuesi i trupës gjyquese, Znj. Suela Zhegu. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupës gjyquese, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit.

Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK); dhe Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD).

Këto raporte janë administruar nga relatori, me fillimin e hetimit administrativ.

Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI) ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me shkresën nr. *** prot., datë 16.11.2017, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit ka konstatuar se:

- 1) *Deklarimi është i saktë dhe në përputhje me ligjin;*
- 2) *Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- 3) *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- 4) *Nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- 5) *Nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklaramëve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontaktet të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. *** prot., datë 02.11.2017, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016; në përfundim të të cilit ka konstatuar *përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, Z. Edmond Islamaj.*

Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLD) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me nr.*** prot., datë 21.11.2017.

Në vijim, nga ana e relatorit të çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në nenin 14, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm.

Trupa gjyquese, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, më datë 15.05.2018, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, Z. Edmond Islamaj, si dhe njoftimin e këtij subjekti për t'u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35-40 dhe 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative.

Subjekti i rivlerësimit u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja, lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga ana e Komisionit më datë 15.05.2018. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet

e dosjes më datë 18.05.2018 dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja më datë 28.05.2018.

Pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupa gjyquese, në prani të përfaqësuesit të vëzhguesve ndërkombëtarë, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

II. SEANCA DËGJIMORE

Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht, më datë 28.05.2018.

Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, më datë 05.06.2018, ora 10:00 paradite, në Sallën e Konferencave, në Pallatin e Kongreseve, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, Z. Ferdinando Buatier De Mongeot.

Në këtë seancë subjekti i rivlerësimit, që u paraqit dhe u mbrojt personalisht, shprehu opinionin e tij në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer.

Në përfundim, subjekti i rivlerësimit, Z. Edmond Islamaj, kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Z. Edmond Islamaj ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit ndaj tij, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ. Ai ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016.

A. VLERËSIMI I PASURISË

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) Provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”;
- b) Raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI-ja;
- c) Provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- ç) Deklarimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- d) Shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit;
- dh) Deklarimet e personave të tjerë të lidhur.

Në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”, të dorëzuar pranë ILDKPKI-së më datë 31.01.2017, subjekti deklaroi në emër të tij këto pasuri (të paluajtshme dhe të luajtshme):

1. **Apartament banimi**, me sipërfaqe 81.54 m², me nr. pasurie ***, ZK ***, ndodhur në Durrës, Lagjja nr. ***, Rr. “****” (“****”), pallati nr. ***. Në bashkëpronësi me prindërit, duke zotëruar 1/3-ën e pronësisë së apartamentit. Fituar me kontratë privatizimi, datë 20.08.1993, me Ndërmarrjen Komunale Banesa. Vlera: 22,509 lekë.

Burimi i deklaruar i krijimit sipas “Deklaratës së Pasurisë, Vetting”: Nuk deklaroi burim.

Në lidhje me këtë apartament, subjekti ka vënë në dispozicion:

- Certifikatë pronësie nr. ***, datë 23.05.2012;
- Vërtetim nr. *** rep. dhe nr. *** kol., datë 13.10.1993;
- Autorizim, Komiteti Ekzekutiv KP Durrës, datë 09.07.1982;
- Formular nr. ***, Kontratë për Privatizimin e Banesës;
- Mandat arkëtimi nr. ***;
- Autorizim i Komisionit të Privatizimit të Banesave, datë 05.10.1993.

Hetimi i kryer nga Komisioni:

- Shkresë nr. ***prot., datë 19.12.2017, drejtuar ZVRPP-së Durrës.

Shkresë nr. *** prot., datë 15.01.2018, e ZVRPP-së Durrës, *nëpërmjet së cilës na vihen në dispozicion kartelat e pasurive në pronësi të Z. A.T, Znj. S.T dhe Z. Edmond Islamaj, por nuk na vihen në dispozicion dosjet e plota të këtyre pasurive për të evidentuar saktë këto pasuri.*

Shkresë nr. *** prot., datë 26.01.2018, e ZVRPP-së Durrës, *nëpërmjet së cilës plotësohen të dhënat e dërguara me shkresën e mësipërme.*

- Shkresë nr. *** prot., datë 19.12.2017, drejtuar Ministrisë së Drejtësisë.

Ministria e Drejtësisë ka kthyer përgjigje më datë 29.12.2017, me shkresë nr. *** prot., nga e cila rezultojnë disa veprime noteriale në vitin 2017 dhe 2014. Për këto veprime u është kërkuar informacion noterëve përkatës.

- Shkresë nr. *** prot., datë 12.1.2018, drejtuar noterit publik, Z. Sh.C.

Me shkresën, datë 22.01.2018, noteri publik Sh.Cna vë në dispozicion: *Kontratë dhurimi nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.04.2017, lidhur midis Znj. H dhe Z. B. Isi dhurues dhe Z. Edmond Islamaj si pranues i dhurimit. Nëpërmjet kësaj kontrate, B dhe H.I i dhurojnë Edmond Islamajt 2/3-ën (54.36m²) e apartamentit që kanë në bashkëpronësi, me vlerë 2 836 396 lekë, duke e bërë atë pronar të vetëm të këtij apartamenti.*

Arsyetimi ligjor:

Apartamenti i banimit është blerë me kontratë privatizimi, më datë 05.10.1993, nga ku bashkëpronarë rezultojnë të kenë qenë prindërit e subjektit të rivlerësimit, vëllai i tij (E.I) dhe vetë subjekti i rivlerësimit. Nga verifikimi i deklaratës së interesave private të vitit 2003 rezulton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka në pronësi 1/4-ën pjesë takuese të këtij apartamenti, ndërsa në “Deklaratën e Pasurisë, Vetting”, ai deklaron se ka 1/3-ën pjesë takuese të këtij apartamenti. Bazuar në shkresën e ZVRPP-së Durrës, rezulton se ky apartament është regjistruar që në fillim vetëm në bashkëpronësi të subjektit të rivlerësimit dhe prindërve të tij, ku secili prej tyre ka 1/3-ën pjesë takuese të këtij apartamenti. Duke qenë se në shkresën e ZVRPP-së Durrës nuk vihet në dispozicion asnjë dokument për të shpjeguar faktin se pse nuk rezulton si bashkëpronar Z. E.I, subjektit iu kërkua informacion shtesë. Në përgjigjen e tij, më datë 15.02.2018, subjekti sqaron se bashkëpronarë kanë qenë vetëm prindërit e tij dhe ai vetë. Duke qenë se me ta jetonte edhe vëllai i tij, ai e konsideron si një gabim material të bërë nga ana e tij.

Në këto kushte, bazuar në dokumentacion e vënë në dispozicion nga ZVRPP Durrës arsyetohet se, pavarësisht se në kontratën e privatizimit të datës 05.10.1993 rezulton edhe emri i vëllait të subjektit, bazuar në nenin 9 të ligjit nr.7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, banesat që privatizoheshin regjistroheshin vetëm në emër të qiramarrësit dhe anëtarëve të tjerë madhorë të familjes së tij. Duke qenë se vëllai i subjektit, Z. E.I, është i datëlindjes 1975, është e kuptueshme përse emri i tij nuk mund të ishte në certifikatën e pronësisë së këtij apartamenti, sepse ai nuk ka qenë madhor në momentin e privatizimit të kësaj banese.

Ndërkohë, pas periudhës së deklarimit, me anë të kontratës së dhurimit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.04.2017, lidhur midis Znj. H dhe Z. B.I si dhurues dhe Z. Edmond Islamaj si pranues i dhurimit, subjektit i ka kaluar pronësia 100% mbi këtë apartament.

Në përfundim të kësaj analize, vërehet se:

- ✓ Përputhet deklarimi i subjektit me të dhënat e administruara.

✓ Subjekti ka pasur mundësi financiare për këtë pasuri të paluajtshme.

- 2. Tokë arë**, me sip.1000 m², me nr. pasurie ***, ndodhur në ***, Kavajë, fituar me kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.03.2015, me vlerë 137,000 lekë. Në pronësi të subjektit të rivlerësimit.

Burimi i deklaruar i krijimit sipas “Deklaratës, Vetting”: *Të ardhura nga paga ndër vite.*

Për këtë pasuri, subjekti ka vënë në dispozicion:

- Certifikatë pronësie nr. ***, datë 01.04.2015;
- Kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.03.2015.

Hetimi i kryer nga ana e Komisionit:

- Shkresë nr. ***, datë 19.12.2017, dërguar ZVRPP-së Kavajë.

Me shkresën nr. ***, datë 22.12.2017, ZVRPP Kavajë *na vë në dispozicion kartelën e pasurisë së kësaj prone.*

Arsyetimi ligjor:

Subjekti i rivlerësimit, më datë 26.03.2015, me kontratë shitjeje nr. ***rep., nr. *** kol., ka blerë një tokë arë me sipërfaqe 1000 m². Nga hetimi administrativ, bazuar në shkresën eZVRPP-së Kavajë rezulton se subjekti ka një pasuri të tipit kullotë me sipërfaqe 1000 m² të ndodhur në ***, Kavajë. Shuma e paguar për këtë pasuri të paluajtshme është 137,000 lekë. Nga analiza financiare e subjektit, konstatohet se ai i ka pasur mundësitë financiare për këtë blerje.

Në përfundim të kësaj analize, konstatohet se:

- ✓ Përputhet deklarimi i subjektit me të dhënat e administruara.
- ✓ Subjekti ka pasur mundësi financiare për këtë pasuri të paluajtshme.

- 3. Llogari**,depozitë kursimi pranë “Intesa Sanpaolo Bank” (ish-Banka Italo-Shqiptare) krijuar në vitin 2000, depozitë fillestare në vlerën 5,000 euro, në pronësi të subjektit të rivlerësimit.

Burimi i deklaruar i krijimit, sipas “Deklaratës-Vetting”: *Kursime nga të ardhurat. Balanca më datë 23.01.2017, në shumën 6,857.12 euro.*

Në lidhje me këtë depozitë kursimi, subjekti ka vënë në dispozicion:

- Vërtetim nga “Intesa Sanpaolo Bank”, datë 23.01.2017.

Hetimi i kryer nga ana e Komisionit:

- Shkresë nr. *** prot., datë 19.12.2017, drejtuar 27 bankave.

“Banka Intesa Sanpaolo”, me shkresë nr. *** prot., datë 29.12.2017, informon se:
Z.Edmond Islamaj ka pasur llogari pranë kësaj banke në euro.

Arsyetimi ligjor:

Bazuar në nxjerrjen e llogarisësë “Intesa Sanpaolo Bank”, rezulton se Z. Edmond Islamaj ka hapur një llogari bankare më datë 29.08.2000, me vlerë 5,191 euro, e konvertuar në lekë me kursin mesatar të vitit 2000 nga Banka e Shqipërisë (132.58) në vlerën 688,281 lekë, ndërsa në datën 19.12.2017 kjo llogari ka qenë në vlerën 6,857.20 euro.

Nga analiza financiare për periudhën 1992-2000, rezulton se:

1. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar apartament banimi, me sipërfaqe 81.54 m², përfituar nga privatizimi i ish-banesave shtetërore në vitin 1993, ndodhur në Durrës, Lagjja nr.***, Rr.“***” (“***”), pallati nr. ***, me vlerë 22 509 lekë.
2. Shpenzimet e jetesës për periudhën 1992- 2000 janë në shumën 480,000 lekë (Për periudhën 1992-2000 është marrë si mesatare shuma prej 5,000 lekësh/muaj shpenzime jetese për subjektin)¹.
3. Të ardhurat e subjektit për periudhën 1992-2000, referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion në total, janë 1,822,161 lekë, sipas tabelës së mëposhtme:

Vitet	Të ardhura nga paga të subjektit (Në lekë)
1992	11,400
1993	19,334
1994	20,857
1995	97,626
1996	269,208
1997	269,208
1998	286,181
1999	429,242
2000	419,106
Totali	1,822,161

¹Shpenzimet e jetesës për subjektin e rivlerësimit për periudhën 1992-2000 janë llogaritur përafërsisht, duke marrë në konsideratë nivelin e pagave gjatë kësaj periudhe, përbërjen familjare të subjektit, dhe si shpenzim mujor një vlerë e përafërt që zë rreth 26% të totalit të të ardhurave.

Bazuar në të dhënat e mësipërme, në tabelën e mëposhtme është llogaritur aftësia financiare e subjektit për të çelur këtë depozitë.

Përshkrimi	1992-2000 (në lekë)
Apartament banimi i përfituar nga privatizimi, 1/3-a pjesë takuese	0
Depozitë e çelur në vitin 2000, me vlerë 5,191.44 euro	-688,281
Të ardhura nga pagat e subjektit	1,822,161
Shpenzime jetese, subjekti	-480,000
Diferenca e mbetur për shpenzime të tjera	653,880

Në përfundim të analizës së mësipërme konstatohet se:

- ✓ Përputhet deklarimi i subjektit me të dhënat e administruara.
- ✓ Subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të krijuar depozitën prej 5,000 eurosh në vitin 2000.

4. Depozitë kursimi pranë “BKT”-së, në shumën 20,000 euro. Në pronësi të subjektit të rivlerësimit, krijuar në vitin 2016.

Burimi i deklaruar i krijimit sipas “Deklaratës, Vetting”: *Nga të ardhurat ndër vite.*

Në lidhje me këtë depozitë kursimi, subjekti ka vënë në dispozicion:

- Vërtetim nr. *** prot., datë 23.01.2017, i “BKT”-së.

Hetimi i kryer nga ana e Komisionit:

- Shkresë nr. *** prot., datë 19.12.2017, drejtuar 27 bankave.

“BKT”, me shkresën***, datë 4.01.2018, na informon se: *Z. Edmond Islamaj ka llogari bankare pranë kësaj banke.*

Arsyetimi ligjor:

Bazuar në shkresën e “BKT”-së, rezulton se Z. Edmond Islamaj ka një llogari bankare depozitë në vlerën 20,000 euro.

Me qëllim konfirmimin e burimit të të ardhurave për krijimin e kësaj depozite, më datë 05.02.2018, subjekti u pyet në lidhje me burimin e të ardhurave të ligjshme për këtë

depozitë. Në përgjigjen e tij, të datës 15.02.2018, subjekti sqaron se si burim krijimi i kësaj depozite janë të ardhurat familjare, që përbëhen nga paga e tij dhe e bashkëjetueses.

Për të vërtetuar këtë, bazuar mbi vërtetimet e pagave të subjektit dhe bashkëjetueses së tij, Komisioni bëri një analizë financiare të të gjitha të ardhurave, shpenzimeve dhe kursimeve të subjektit dhe bashkëjetueses së tij gjatë viteve 2005-2016. Sipas tabelës së mëposhtme, rezultoi se ai dhe bashkëjetuesja e tij kanë pasur burime të mjaftueshme të ardhurash për të hapur depozitat përkatëse, në shumën 20,000 euro pranë “BKT”-së dhe 15,000 euro pranë “Credins Bank”.

Vitet	Depozitë kursimi në Bankën Italo-Shqiptare/ subjekti	Kursime nga paga/ subjekti	Kursime nga paga/ bashkëjetuesja	Kursime nga paga/ bashkëjetuesja, të depozituara në Raiffeisen Bank	Depozitë kursimi pranë BKT/ subjekti	Depozitë kursimesh pranë Credins Bank/ bashkëjetuesja	Llogari në ProCredit Bank/ bashkëjetuesja	Llogari rrjedhës se Raiffeisen Bank/ subjekti	Llogari rrjedhës Raiffeisen Bank/ bashkëjetuesja	Llogari rrjedhës e subjektit në Credins Bank
2003	746,159						131,004			
2004	716,911						171,000			
2005	612,700	600,000					183,037	460	16,253	
2006	710,428	1,300,000		936,720			173,200	2,766	38,745	
2007	728,705	1,700,000		864,394			181,773	9,912	(7)	
2008	765,891	2,300,000	305,115	945,984			190,444	53,529	4,441	77,019
2009	877,018	2,816,458	705,115	1,015,454			214,680	233,542	8,875	17,530
2010	907,130	2,021,502	1,671,545	1,155,730			214,680	296,566	(34,593)	32,386
2011	920,185	2,383,620	2,115,685	1,157,162			228,591	323,595	(22,732)	114,287
2012	944,447	2,383,620	2,115,685	1,203,495			240,383	323,624	(35,983)	809,726
2013	957,581	2,383,620	2,115,685	1,184,740			240,383	323,653	(38,228)	1,056,363
2014	960,280	2,533,620	2,115,685	1,315,041			240,383	323,682	32	1,307,405
2015	943,756	2,683,620	2,115,685	1,465,477			95,920	323,710	0	1,399,967
2016	927,563	-	-	1,552,681	2,705,400	2,029,050	-	323,737		1,136,078

Në përfundim të analizës së mësipërme konstatohet se:

- ✓ Përpulthet deklarimi i subjektit me të dhënat e administruara.
- ✓ Subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të krijuar depozitën prej 20,000 eurosh në Bankën Kombëtare Tregtare në vitin 2016.

5. **Llogari page**, në “Credins Bank”, me gjendje 1,191,617 lekë, në pronësi të subjektit të rivlerësimit.

Subjekti ka vënë në dispozicion fotokopje të:

- Vërtetimit nr.*** prot., datë 19.01.2017, të “Credins Bank”.

Hetimi i kryer nga ana e Komisionit:

- Shkresë nr. *** prot., datë 19.12.2017, drejtuar 27 bankave.

“Credins Bank”, me shkresën nr. *** prot., datë 11.01.2018, informon se:
Z. Edmond Islamaj ka llogari bankare pranë kësaj banke.

Arsyetimi ligjor:

Bazuar në shkresën e “Credins Bank”, rezulton se Z. Edmond Islamaj ka një llogari bankare page pranë kësaj banke me gjendje në fund të vitit 2016 në vlerën 1,136,078 lekë, ndërsa më datë 19.01.2017 ka pasur gjendje 1,191,617 lekë, referuar vërtetimit nr.*** prot., datë 19.01.2017, të bankës “Credins”, depozituar nga ana e subjektit të rivlerësimit. Të gjitha këto të ardhura janë rezultat i pagës së subjektit.

- ✓ Komisioni konstaton përputhshmërinë e deklaratës së subjektit me të dhënat e bankës.

Në “Deklaratën e Pasurisë, Vetting”, të dorëzuar pranë ILDKPKI-së më datë 31.01.2017, subjekti deklaron në emër të bashkëjetueses së tijkëto pasuri (të paluajtshme dhe të luajtshme):

1. **Apartament** banimi, me sip. 141.13 m², me adresë: Rr. ***, H. 1, Durrës.
Garazh, me sip. 16 m², me adresë: Rr. ***, Durrës.
Dyqan, me sip. 55m², me adresë: Rr. ***, Durrës.

Vlera totale e blerjes së këtyre pasurive të mësipërme është 1,000,000 lekë. Fituar nëpërmjet kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.11.2001, lidhur me babain e saj, Z. A.T.

Burimi i krijimit sipas “Deklaratës së Pasurisë, Vetting”: Nuk ka deklaruar burim.

Subjekti ka vënë në dispozicion fotokopje të këtyre dokumenteve:

- Certifikatë pronësie nr. ***, datë 25.01.2017;
- Certifikatë pronësie nr. ***, datë 25.01.2017;

- Certifikatë pronësie nr. ***, datë 25.01.2017;
- Kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.11.2001;
- Kontratë sipërmarrjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.09.1998;
- Aktmarrëveshje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.12.2000;
- Vërtetim pronësie, datë 16.02.1995;
- Kontratë dhurimi, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.04.1993;
- Kontratë dhurimi (s'ka numër).

Hetimi i kryer nga ana e Komisionit:

- Shkresë nr. *** prot., datë 19.12.2017, drejtuar ZVRPP-së Durrës.

Shkresë nr. *** prot., datë 15.1.2018, të ZVRPP-së Durrës, *nëpërmjet së cilës na vihen në dispozicion kartelat e pasurive në pronësi të Z. A.T, Znj. S.T dhe Z. Edmond Islamaj, por nuk na vihen në dispozicion dosjet e plota të këtyre pasurive për t'i evidentuar saktë këto pasuri.*

Shkresë nr. *** prot., datë 26.1.2018, të ZVRPP-së Durrës, *nëpërmjet së cilës plotësohen të dhënat e dërguara me shkresën e mësipërme.*

Arsyetimi ligjor:

Bashkëjetuesja e subjektit të rivlerësimit i ka përfituar pasuritë e mësipërme nga kontrata e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.11.2001, lidhur me babain e saj, Z. A.T. Këto pasuri, Z. T i ka përfituar në cilësinë e pronarit të truallit, bazuar në aktmarrëveshjen nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.12.2000, lidhur me shoqërinë “****” sh.p.k. Aktmarrëveshja e mësipërme është rrjedhojë e kontratës së sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., të lidhur më datë 17.09.1998, midis Z. A.T dhe shoqërisë “****”sh.p.k.

Nga kartelat e pasurisë rezultojnë se:

- a) Vlera reale e apartamentit është 10,519,930 lekë, pasi është bërë rivlerësimi i tij më datë 15.05.2012. Kalimi i pasurisë është bërë më datë 4.05.2012 te babai i bashkëjetueses së subjektit dhe më pas, më datë 14.05.2012, është bërë kalimi i pasurisë te Znj. S.T, bashkëjetuesja e subjektit.
- b) Vlera reale e dyqanit është 6,149,550 lekë, pasi është bërë rivlerësim i tij më datë 15.05.2012. Kalimi i pasurisë është bërë më datë 04.05.2012 te babai i bashkëjetueses së subjektit dhe më pas, më datë 14.05.2012, është bërë kalimi i pasurisë te Znj. S.T, bashkëjetuesja e subjektit.
- c) Vlera reale e garazhit është 834,848 lekë, pasi është bërë rivlerësim i tij. Kalimi i pasurisë është bërë më datë 4.05.2012 te babai i bashkëjetueses së subjektit dhe më

pas, më datë 14.05.2012, është bërë kalimi i pasurisë te Znj. S.T, bashkëjetuesja e subjektit.

Referuar vërtetimit nga dokumenti hipotekor, datë 23.01.2002, i ZVRPP-së Durrës, i lëshuar sipas kërkesës nr. ***, datë 23.11.2001, administruar nga ana e Komisionit me shkresë nr. *** prot., datë 26.1.2018, rezulton se Znj. S.T ka në pronësi pasuritë e mësipërme, të cilat figurojnë të regjistruara në regjistrin hipotekor nr. ***, datë 19.01.2002.

Lidhur me çmimin e shitblerjes, duke qenë se kemi të bëjmë me një kontratë shitblerjeje ndërmjet babait dhe vajzës, nisur edhe nga fakti se në këtë periudhë të lidhjes së kësaj kontrate nuk ka një çmim të detyrueshëm reference për metër katror, nuk lindin dyshime të arsyeshme për shkelje ligjore.

Nga ana tjetër, analiza financiare e bashkëjetueses së subjektit vërteton mundësitë e saj për blerjen e kësaj pasurie në shumën 1,000,000 lekë.

- ✓ Nga analiza e dokumentacionit rezulton se subjekti ka qenë i saktë dhe i vërtetë në deklarinimin e tij.

2. Dy garsoniere, me sip. 32 m², te*, Durrës.**

Burimi i krijimit sipas “Deklaratës së Pasurisë, Vetting”: *Lënë në përdorim nga babai, Z. A.T.*

Subjekti ka vënë në dispozicion:

- Vendimin nr. ***, datë 16.01.1997, të Komisionit të Kompensimit Fizik të Pronave ish-pronarëve të rrethit Durrës;
- Vërtetim pronësie, datë 09.06.1999;
- Kontratë sipërmarrjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.01.2004.

Hetimi i Kryer nga ana e Komisionit:

- Shkresë nr. *** prot., datë 19.12.2017, drejtuar ZVRPP-së Durrës.

Shkresë nr. *** prot., datë 15.01.2018, të ZVRPP-së Durrës, *nëpërmjet së cilës na vihen në dispozicion kartelat e pasurive në pronësi të Z. A.T, Znj. S.T dhe Z. Edmond Islamaj.*

Arsyetimi ligjor:

Në bazë të vendimit nr. ***, datë 16.01.1997, të Komisionit të Kompensimit Fizik të Pronave ish-pronarëve të rrethit Durrës, është vendosur kompensimi fizik i Z. H.T (një nga trashëgimtarët e të cilit ka qenë edhe Z. A.T) me parcelë nr. ***, me sip. 600 m². Më datë

15.01.2004 është lidhurkontrata e sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., midis shoqërisë “***” (A.C.G) dhe Z. A.T për ndërtimin e një pallati te*** në Durrës.

Bazuar në kartelën e pasurisë, administruar me shkresën nr. *** prot., datë 26.1.2018, të ZVRPP-së Durrës, rezulton se Z. A.T ka në bashkëpronësi me dy motrat e tij një sipërfaqe 600 m² truall me nr. pasurie ***, të ndodhur në ***, Durrës.

Znj. S.T, në “Deklaratën e Pasurisë, Vetting” deklaron se nuk disponon dokumentacion lidhur me përdorimin e këtyre pronave, pasi babait të saj nuk i ka kaluar e drejta e pronësisë në lidhje me këto prona.

Për të sqaruar këtë pikë, më datë 05.02.2018, subjektit iu kërkuan sqarime në lidhje me kohën e përdorimit të këtyre dy garsoniereve, si dhe dokumentacioni që provonte pronësisë e Z. T mbi to.

Në përgjigjen e tij, të datës 15.02.2018, subjekti deklaron se Znj. S.T i ka në huapërdorje këto garsoniere, që nga viti 2010-2011. Ato ia ka dhënë në huapërdorje i ati i saj, Z. A.T, dhe janë rezultat i një kontrate sipërmarrjeje të papërfunduar për sa i përket anës ligjore të nënshkruar mes pronarëve të truallit (Z. A.T për pjesën takuese) dhe investitorit-ndërtues. I gjithë ndërtimi, dhe natyrisht këto garsoniere, për shkak të mospërfundimit nga ana e investitorit të procesit ligjor të dokumentacionit, nuk është i regjistruar juridikisht pranë ZVRPP-së dhe për këtë shkak nuk disponohet ndonjë akt pronësie.

Subjekti vuri në dispozicion të Komisionit aktet provuese të pronësisë mbi tokën e babait të bashkëjetueses:

- Vendimi nr. ***, datë 16.01.1997, i Komisionit të Kompensimit Fizik të Pronave Durrës, me të cilin i është kthyer fizikisht sipërfaqja e truallit mbi të cilin është bërë ndërtimi ku janë dhe garsonieret, vendndodhja e kësaj sipërfaqeje trualli është përcaktuar me short për të gjithë ish-pronarët Durrës;
- Vërtetimin e pronësisë të Hipotekës Durrës, datë 09.06.1997, për regjistrimin e kësaj sipërfaqeje trualli në emër të ish-pronarëve, babait të bashkëjetueses, Z. A.T, shoqëruar me skicën përkatëse të vendndodhjes;
- Kontratën e sipërmarrjes ndërmjet firmës ndërtuese dhe ish-pronarëve, datë 15.01.2004.

Subjekti sqaron se pikërisht pas kontratës së sipërmarrjes është ndërprerë dhe ana dokumentare ndërmjet firmës ndërtuese dhe ish-pronarëve. Por, sipas tij, i ati i bashkëjetueses, ka premtuar se kur t’i marrë ato në pronësi, dëshiron t’ia kalojë në pronësi Znj. T.

Përveç kësaj, subjekti deklaron se: *“Nisur nga vështirësitë e investitorit për përfundimin e anës dokumentare me leje e regjistrim, realisht nuk dihet nëse do të ndodhë juridikisht dhe kur do të ndodhë ky fakt. Sqaroj se, edhe nga pikëpamja faktike, garsonieret nuk janë përdorur nga ana e bashkëjetueses sime, për shkak të mungesës së infrastrukturës dhe kushteve jo të përshtatshme.”*

Subjekti nuk është i qartë në kthimin e përgjigjes së tij, pasi fillimisht deklaroi se bashkëjetuesja i ka në huapërdorje këto garsoniere dhe, më pas, deklaroi se ato nuk janë përdorur për shkak të mungesës së infrastrukturës dhe kushteve jo të përshtatshme.

Për të sqaruar paqartësitë, më datë 20.04.2018, u thirr për të dhënë deklaratimet e tij në lidhje me këtë situatë Z. A.T.

Ai deklaroi se: *“Kishim 600 m², ia dhamë firmës për ndërtim, u ndërtua pallati dhe ne, bashkë me motrat, morëm disa apartamente pa letra. Ujin e kemi bërë vetë, me lekët tona, edhe dritat i bëmë vetë, s’kemi dokumente. Unë kam 3 garsoniere dhe një apartament 1+1. Janë pjesërisht të mobiluara, nuk i kemi dhënë asnjëherë me qira. Do t’ua jap fëmijëve të mi, kur të bëhen letrat, siç kam bërë deri më sot.”*

Duke arsyetuar mbi bazën e dokumenteve dhe deklaratimeve të subjektit të rivlerësimit dhe Z. A.T, gjykojmë se ndodhemi përpara një situatë jo pak të njohur dhe të shpeshtë në marrëdhëniet midis pronarëve të truallit dhe sipërmarrësve. Për shkaqe të panjohura zyrtarisht, por që mund t’i hamendësojmë si ekonomike, firma ndërtuese nuk e ka përfunduar ende ndërtimin dhe infrastrukturën e pallatit. Në këtë mënyrë, ky pallat ka mbetur ende pa u hipotekuar duke mos krijuar mundësinë e pajisjes me certifikatë pronësie të pronarëve të truallit. Gjithsesi, mbetet fakt i dokumentuar se Z. A.T është pronar i truallit mbi të cilin është ngritur pallati dhe për pasojë gëzon të drejtën e pronësisë mbi apartamentet, për të cilat është dakordësuar me firmën ndërtuese.

✓ Në këto kushte, çmohet se nuk ka dyshime për fshehje të pasurisë apo të të ardhurave që mund të burojnë prej saj. Subjekti ka qenë korrekt në deklaratimin e së drejtës së përdorimit të këtyre dy garsonierave.

3. Autoveturë për përdorim personal, e markës “Hyundai”, e vitit 2008, me targë ***, blerë më datë 21.09.2015, me kontratë shitblerjeje me çmim 3,000 euro.

Burimi i krijimit sipas “Deklaratës së Pasurisë, Vetting”: *Të ardhura familjare.*

Subjekti ka vënë në dispozicion:

- Leje qarkullimi rrugor, ***;
- Kontratë shitblerjeje automjeti, datë 21.09.2015;
- Faturë nr. ***, datë 21.09.2015.

Hetimi i kryer nga Komisioni:

- Shkresë nr. *** prot., datë 19.12.2017, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

Me shkresën nr. *** prot., datë 27.12.2017, DPSHTRR na informon:

Z. Edmond Islamaj ka pasur në bashkëpronësi me Z. B.I mjetin me targa *** deri në datën 14.07.2017.

Znj. S.A ka në pronësi mjetin me targë ***.

Me shkresën nr. *** prot., datë 12.01.2018, DPSHTRRna ka vënë në dispozicion dokumentet e mjetit ***, nga ku rezulton se është blerë në vlerën 3,000 euro.

Arsyetimi ligjor:

Mbështetur në shkresën nr. *** prot., datë 12.01.2018, dhe shkresën nr. *** prot., datë 27.12.2017, të DPSHTRR-së rezulton se Znj. S.T ka në pronësi mjetin tip “Hyundai”, blerëme çmim 3,000 euro. Nga analiza financiare për Znj. S.T rezulton se i ka pasur mundësitë financiare për të blerë këtë mjet në shumën 3,000 euro.

✓ Përputhet deklarata e subjektit me të dhënat e DPSHTRR-së.

4. Llogari,depozitë në“Raiffeisen Bank”, me balancë deri më 16.01.2017, në shumën 12,101.4 USD. Hapur në vitin 2006, me shumë fillestare 10,000 USD.

Burimi i krijimit sipas “Deklaratës së Pasurisë, Vetting”: *Të ardhurat familjare.*

Subjekti ka vënë në dispozicion:

- Vërtetim, datë 23.01.2017, i “Raiffeisen Bank”, shoqëruar me nxjerrjen e llogarisë.

Hetimi i kryer nga ana e Komisionit:

➤ Shkresë nr. *** prot., datë 19.12.2017, drejtuar 27 bankave.

Banka “Raiffeisen”, me shkresë nr. *** prot., datë 26.12.2017,informon se:Z. Edmond Islamaj, Z. B.I, Znj. H.I dhe Znj. S.T, kanë ose kanë pasur llogari bankare pranë kësaj banke.

Arsyetimi ligjor:

Bazuar në shkresën e “Raiffeisen Bank” rezulton se Znj. S.T ka llogari në valutë pranë kësaj banke me gjendje 12,085 USD, e cila është krijuar në vitin 2006, vit kur ajo ka depozituar në bankën “Raiffeisen” shumën prej 10,000 USD, konfirmuar me shkresën nr. *** prot., datë 26.12.2017, të bankës “Raiffeisen”.

Nga analiza financiare për periudhën 1992 - 2006 të bashkëjetueses së subjektit të rivlerësimit, rezulton se:

1. Gjendja e likuiditetit deri më datë 31.12.2005 është 0 lek.
2. Të ardhurat nga paga nga viti 1992 deri në vitin 2006 kanë qenë në shumën prej 3,487,566 lekësh.
3. Shpenzimet e bashkëjetueses së subjektit nga viti 1996 deri në vitin 2006 për konsum personal + pjesa takuese e shpenzimit për një fëmijë, kanë qenë në total në shumën prej 1,368,000 lekësh.
4. Paguar nga bashkëjetuesja për apartamentin e blerë në vitin 2001 vlera prej 1,000,000 lekësh.
5. Gjendja e likuiditetit më 31.12.2006 ka qenë 10,000 USD ose, e konvertuar në lekë me kursin mesatar të Bankës së Shqipërisë për vitin 2006, në vlerën prej 936,720 lekësh.

Gjendja e likuiditetit 31.12.2005	0
TË ARDHURA	3,487,566
SHPENZIME	- 1,368,000
Paguar blerja e apartamentit në 2001	- 1,000,000
Gjendja e likuiditetit 31.12.2006 (depozita prej 10,000 USD)	936,720
Diferenca e mbetur për shpenzime të tjera (në lekë)	182,846

- ✓ Komisioni çmon se personi i lidhur/bashkëjetuesja e subjektit ka qenë në gjendje të krijojë nga të ardhurat personale depozitën prej rreth 10,000 USD në vitin 2006.

- 5. Llogari, depozitë kursimesh** pranë “Credins Bank” deri më 19.01.2017, në shumën 15,000 euro.

Burimi i krijimit sipas “Deklaratës së Pasurisë, Vetting”: *Të ardhura familjare.*

Subjekti ka vënë në dispozicion:

- Vërtetim i bankës “Credins” nr. ***, datë 19.01.2017.

Hetimi i kryer nga ana e Komisionit:

- Shkresë nr. *** prot., datë 19.12.2017, drejtuar 27 bankave.

“Credins Bank”, me shkresë nr. *** prot., datë 11.01.2018, informon se: *Z. Edmond Islamaj dhe Znj. S.T kanë llogari bankare pranë kësaj banke. Znj. S.T ka llogari depozite në shumën 15,000 euro.*

Arsyetimi ligjor:

Nisur nga dokumentacioni i administruar, me qëllim konfirmimin e burimit të të ardhurave për krijimin e kësaj depozite, më datë 05.02.2018, subjekti u pyet për burimin e këtyre të ardhurave.

Me përgjigjen e datës 15.02.2018, ai konfirmon se kjo depozitë buron nga të ardhurat familjare, paga e tij dhe e bashkëjetueses.

Për të verifikuar saktësinë e këtij deklarami, Komisioni kreu një analizë financiare të të gjitha të ardhurave dhe shpenzimeve familjare të subjektit, si dhe deklaramit të kursimeve *cash* ndër vite. Kjo analizë përputhet me atë të kryer nga ana e Komisionit për depozitën e kursimit në shumën prej 20.000 eurosh, në pronësi të subjektit.

Në konkluzion të analizës, vlerësojmë se subjekti dhe bashkëjetuesja e tij i kanë mbajtur në gjendje *cash* të gjitha kursimet e tyre ndër vite. Këto kursime janë deklaruar periodikisht pranë ILDKPKI-së. Në vitin 2016, të gjitha kursimet e grumbulluara kanë shërbyer si burim për të dyja depozitat e hapura, si nga subjekti, ashtu dhe bashkëjetuesja e tij.

Nga dokumentacioni i dorëzuar nga “Credins Bank”, rezulton gjithashtu se më datë 20.05.2016 është lidhur një kontratë *overdraft* (huaje) midis kësaj banke dhe Znj. S.T në shumën 300,000 lekë, me qëllim kreditim kartë krediti “Visa Classic”. Kjo kontratë *overdraft* është deklaruar nga subjekti.

✓ Përputhet deklarata e subjektit me të dhënat e bankës.

6. Në lidhje me të ardhurat e deklaruara nga bashkëjetuesja, Znj. S.T, rezulton se:

- Për periudhën qershor 1999- shtator 1999 ka deklaruar se ka marrë 400 USD. Për të provuar periudhën e punësimit është dorëzuar vërtetimi, datë 13.09.1999, nga “International Crisis Group”, ku rezulton se ka punuar tre muaj, por nuk ka të evidentuar pagë.
- Bashkëjetuesja ka deklaruar të ardhura nga qiraja për periudhën 2006-2011 në shumën 1,935,000 lekë.

Nga analiza e kryer, verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti, si dhe shkresa nr. *** prot., datë 06.02.2018, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës, Komisioni konstatoi se të ardhurat e siguruara nga bashkëjetuesja e subjektit, për të cilat është paguar tatimi i mbajtur në burim, nuk rezultonin në shumën e deklaruar nga subjekti. Nga përlllogaritjet rezultoi se bashkëjetuesja e subjektit, nga kontratat e qirasë kishte siguruar shumën neto 1,612,000 lekë dhe jo shumën 1,935,000 lekë, siç ishte deklaruar nga subjekti.

Pasi u njoh me rezultatet e hetimit, subjekti, përveç shpjegimeve të tij, paraqiti para Komisionit edhe prova të reja, dokumentacion bankar, sipas të cilit vërtetohet pagesa e tatimit në burim për të gjithë shumën e deklaruar si të ardhur nga bashkëjetuesja e subjektit, duke konfirmuar kështu vërtetësinë e deklaramit të tij.

Personat e lidhur me subjektin, L.I dhe M.I (fëmijët), kanë në pronësi pasurinë e mëposhtme:

Ndërtesë njëkatëshe, plus truall, me sipërfaqe 106.7 m², fituar me kontratë dhurimi nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.05.2017, dhuruar nga i ndjeri Z. B dhe Znj. H.I (gjyshërit). Vlera e përcaktuar në kontratë për këtë pasuri është 9.111.967 lekë.

Kjo pasuri nuk është deklaruar nga subjekti në “Deklaratën e Pasurisë, Vetting”, sepse veprimi juridik është kryer pas dorëzimit të kësaj deklarate pranë ILDKPKI-së. Komisioni u vu në dijeni të kësaj kontrate dhurimi nëpërmjet të dhënave të administruara nga Regjistri Notalerial shqiptar.

Meqenëse kjo pasuri është në pronësi të fëmijëve të mitur të subjektit, Komisioni hetoi më thellë.

Nga hetimi për këtë pasuri rezultoi se me kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.10.2014, lidhur midis Z. A.T, Znj. S.Q(T), Z. B.H dhe Z. S.H në cilësinë e shitësit dhe Z. B.I në cilësinë e blerësit, pronësia i ka kaluar blerësit. Nëpërmjet kësaj kontrate, i ndjeri B.I i ka blerë krushkut të tij, Z. A.T, dhe anëtarëve të tjerë të familjes së tij (motrës dhe fëmijëve të motrës të ndjerë) një ndërtesë plus truall, me sipërfaqe totale 106.7 m², me çmim blerjeje 3,000,000 lekë. Kjo pasuri është rivlerësuar përpara kontratës së shitblerjes, më datë 06.06.2013. Në këto kushte, ndërrimi i pronësisë nuk është shoqëruar me tatimin përkatës.

Me qëllim verifikimin e aftësisë blerëse të të ndjerit, Z. B.I, Komisioni konstatoi, nga të dhënat e lëvizjeve bankare, se më datë 24.10.2014 Z. A.T ka tërhequr shumën prej 3,000,0000 lekësh dhe ia ka dhënë hua Z. B.I. Këtë shumë, Z. B.I e ka përdorur për të blerë pikërisht këtë pasuri, që ishte në pronësi të huadhënësit dhe të tjerëve.

Për të kuptuar këtë situatë, Komisioni iu drejtua subjektit, i cili nuk e konfirmoi këtë huadhënie. Më pas, u thirr për të dëshmuar Z. A.T, i cili në deklaramin përpara Komisionit nuk pranoi t’i ketë dhënë hua të ndjerit B.I.

Në përfundim, hetimi tregoi se:

- ✓ Nuk kishte asnjë problem, në lidhje me origjinën e ligjshme të kësaj pasurie.
- ✓ Subjekti nuk ishte në gjendje të shpjegonte këtë marrëdhënie ndërmjet të ndjerit, babait të tij dhe Z. A.T.
- ✓ Nuk u evidentua asnjë element provues, për përfshirjen e subjektit të rivlerësimit në këtë proces.

Në lidhje me deklaratat periodike të deklarimit të pasurisë, Komisioni konstaton se subjekti ka qenë në pjesën më të madhe korrekt dhe i saktë.

Në deklarimin e bërë pranë ILDKPKI-së, në vitin 2010, subjekti ka deklaruar blerjen e mjetit tip “L. Rover Discovery”, në shumën 2,861,670 lekë në bashkëpronësi me babain e tij, me faturë tatimore nr. ***, nga kompania “****” sh.p.k., pronar i së cilës është Z. E.Sh.

Pagesa e çmimit të automjetit nuk është bërë nëpërmjet sistemit bankar.

Më datë 12.07.2014, me kontratë nr. *** rep., nr. *** kol., rezulton se ky mjet është shitur për vlerën 20,000 euro te Z. L.S.Sh, i cili është vëllai i Z. E.Sh. Në këtë kontratë thuhet se blerësi do të bëjë pagesën në llogarinë bankare të shitësit. Nga verifikimi i lëvizjeve bankare të subjektit të rivlerësimit dhe babait të tij rezulton se kjo shumë nuk është depozituar në llogari të tyre. Subjekti konfirmon në deklarimin e tij se ka përfituar 40% të çmimit të shitjes, por pa saktësuar apo dhënë informacion mbi mënyrën e lëvrimin të kësaj shume. Ndërsa në shpjegimet përfundimtare, përpara zhvillimit të seancës dëgjimore, subjekti vërtetoi me dokumentacion bankar pagesën për blerjen e këtij mjeti, ndërsa të ardhurat nga shitja i deklaroi të marra *cash*, për shkak të marrëdhënieve shoqërore me blerësin.

Komisioni konstaton se veprimi juridik i shitjes së mjetit është kryer midis dy individëve, që nuk ushtrojnë veprimtari tregtare, për pasojë nuk ekziston detyrimi ligjor për transfertën e çmimit nëpërmjet sistemit bankar. Ky detyrim ekziston vetëm për veprimet ndërmjet subjekteve tregtare midis tyre.

Nga analiza financiare e subjektit të rivlerësimit rezulton se të ardhurat familjare kanë qenë të mjaftueshme që të mbulojnë shpenzimet ndër vite. Po sipas kësaj analize, subjekti rezulton me pamjaftueshmëri të ardhurash në vitin 2015. Komisioni, bazuar në shpjegimet dhe provat e subjektit, vlerëson se këto janë shpenzime të mbuluara nga të ardhurat e siguruara nga shitja e mjetit në vitin 2014. Ndërsa pamjaftueshmëria e të ardhurave për vitin 2016 nuk u mor në konsideratë nga Komisioni, sepse ishte e një shumë e papërfillshme.

Në përfundim të vlerësimit të pasurisë së subjektit, Komisioni konstaton se nga vlerësimi i provave të marra gjatë këtij hetimi administrativ, ka rezultuar se nuk ka dyshime mbi pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe llogaritë e subjektit të rivlerësimit, përfshirë edhe personat e lidhur me të. Po kështu, në të gjitha rastet e hetuara përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjet e ardhura nga organet shtetërore.

B. KONTROLLI I FIGURËS

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjekti të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr.*** prot., datë 2.11.2017, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016. Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

Nga hetimi administrativ nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Për subjektin e rivlerësimit konstatohet se është në kushtet e përshtatshmërisë për vazhdimin e detyrës si gjyqtar.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLD) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me nr. *** prot., datë 21.11.2017.

Raporti për analizën e aftësive profesionale, kryer nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, është bazuar te:

- Formulari i vetëdeklarimit të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënat e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit;
- 5 dosje gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor.

Për subjektin e rivlerësimit, Z. Edmond Islamaj, nuk ka të dhëna në burimet arkivore të KLD-së për periudhën e vlerësimit, për shkak të detyrës që ai ka ushtruar në këtë periudhë. Në lidhje me këtë seksion, nga ana e Komisionit i është dërguar shkresë KLD-së, nr. *** prot., datë 17.01.2018, duke kërkuar informacion mbi Z. Edmond Islamaj.

Me shkresën nr. *** prot., datë 25.01.2018, KLD-ja na informon se për Z. Edmond Islamaj, për periudhën janar 2006 deri më sot, nga kërkimet e deritanishme në zyrën e arkiv/protokollit të këtij institucioni, disponohen 5 ankesa. Nga këto ankesa, vetëm 3 janë hetuar nga KLD-ja dhe në përfundim për to është konkluduar se nuk janë konstatuar

shkelje të ligjit, në mënyrë të atillë që të përbënin shkelje disipline në kuptim të ligjit nr. 9877, datë 18.02.2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

Vlerësimi i aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit nga ana e Komisionit u bazua në gjetjet e këtij raporti, në shpjegimet e dhëna nga subjekti dhe pas një analize të bërë në përputhje me ligjin nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe kreun II të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ku u konstatua:

a) Lidhur me aftësitë profesionale

Subjekti i rivlerësimit, Z. Edmond Islamaj, ka aftësi në arsyetim ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej tij janë të qarta dhe të kuptueshme. Struktura është e organizuar sipas një metodologjie të caktuar, ku pjesa arsyetuese është e ndarë në nënpjesë. Arsyetimi përmban elementet e nevojshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, duke cituar normat ligjore të zbatueshme në raport me faktet, që i kanë shërbyer gjykatës për nxjerrjen e konkluzioneve.

b) Lidhur me aftësinë organizative

Subjekti i rivlerësimit është eficient dhe efektiv, në drejtim të përfundimit të çështjeve në raport me numrin e çështjeve që atij i caktohen. Ai ka pasur ngarkesë të lartë. Në 3 raste, gjykimet kanë përfunduar tej afateve të arsyeshme. Ai ka vend për të përmirësuar veprimtarinë në drejtim të arsyetimit në kohën e duhur të vendimeve gjyqësore, të cilat nuk janë arsyetuar brenda afateve.

Megjithatë, janë konstatuar mangësi në aftësinë për të administruar dosjet dhe për të mbikëqyrur saktësinë dhe plotësinë e akteve që përfshihen në të.

c) Lidhur me etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale

Subjekti i rivlerësimit, nisur nga rezultati i ankesave për këtë subjekt dhe verifikimi i tyre për periudhën e rivlerësimit, ka treguar angazhim dhe etikë në punë.

Nga shqyrtimi i dosjes për këtë subjekt nuk kanë rezultuar të dhëna në lidhje me ndikimin apo presion të jashtëm.

d) Lidhur me aftësitë personale dhe angazhimin profesional

Lidhur me aftësitë personale dhe angazhimin profesional rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur bashkëveprim në nivelin e duhur me anëtarët e trupit gjykues dhe

administratën gjyqësore, pasi është konstatuar vonesë në nënshkrimin e vendimit përfundimtar dhe depozitim të dosjes në sekretarinë gjyqësore.

Lidhur me aftësitë personale dhe angazhimin profesional rezultojnë se subjekti i rivlerësimit ka aftësi komunikimi dhe ka shprehur gatishmëri për t'u angazhuar në aktivitete profesionale që lidhen me fushën e gjyqësorit.

Subjekti i rivlerësimit, për shkak të funksionit si gjyqtar në Gjykatën e Lartë, nuk ka ndjekur formimin vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, nuk ka qenë subjekt i raporteve të Inspektoratit të KLD-së.

Vlerësimi i aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, Z. Edmond Islamaj, është bazuar edhe në 6 denoncime të bëra pranë Komisionit. Pas shqyrtimit të këtyre denoncimeve, konstatohet se në asnjë prej tyre nuk paraqiten shkaqe apo rrethana për të treguar veprime të njëanshme apo korruptive nga ana e subjektit të rivlerësimit.

Në analizë të raportit të vlerësimit të kryer nga KLD-së, si dhe të shpjegimeve të dhëna nga vetë subjekti, Komisioni vlerëson se mangësitë e konstatuara në vlerësimin profesional janë formale dhe nuk janë të asaj shkalle sa të cenojnë aftësitë profesionale të gjyqtarit.

Për sa më sipërunë, Genta Tafa (Bungo), në cilësinë e relatores së çështjes, pasi hetova raportin e KLD-së dhe denoncimet, nuk gjea indice apo elemente që mund të ngrenë dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e gjyqtarit dhe propozoj për subjektin e rivlerësimit, Z. Edmond Islamaj: "I aftë".

V. KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

Trupa gjyqësore e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konstaton se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel të lartë të vlerësimit të aftësive profesionale,

PËR KËTO ARSYE:

Trupa gjyqësore e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika 1, germa "a", si dhe nenit 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë",

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit e rivlerësimit, Z. Edmond Islamaj, gjyqtar në Gjykatën e Lartë.
2. Vendimi i arsyetuar, me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më datë 07.06.2018.

ANËTARËT E TRUPËS GJYKUESE

SUELA ZHEGU

Kryesuese

PAMELA QIRKO

Anëtare

GENTA Tafa (BUNGO)

Relatore

OLSIDA GOXHAJ

Sekretare gjyqësore